



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 10/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rr. “Armend Daci” nr. 1 Prishtinë, kundër debitorit “ ... - Kompani” sh.p.k, me nr. biznesi ..., me pronar B.S. , me adresë në – Komuna e Kamenicës, për shkak të përbarimit të dokumentit përbarimor, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.289/2018 të datës 11.06.2018 të Përbaruesit Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 28.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “ ... - Kompani” sh.p.k, me nr. biznesi ..., me pronar B.S. , me adresë në – Komuna e Kamenicës, i paraqitur kundër urdhrit përbarimor P.nr.289/2018 të datës 11.06.2018 të Përbaruesit Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan.

II.MBETET në fuqi Urdhri P.nr.289/2018 të datës 11.06.2018 i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rr. “Armend Daci” nr. 1 Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv – vendimit të dhënë në procedurën administrative mbi shqiptimin e gjobës, nr. 4289 të dt. 30.09.2016, ka nxjerrë urdhrin P.nr.298/2018 të datës 11.06.2018, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit, ndaj debitorit “ ... - Kompani” sh.p.k dhe ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit prej 5.000.00 euro, në emër të gjobës administrative të shqiptuar si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifatat në fuqi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se aktvendimi i KPM – së, me nr. protokollit 4288 i dt. 30.09.2018, që paraqet titull ekzekutiv e detyron “... Company” sh.p.k, ndërsa propozimi për përbarim është drejtuar ndaj “... - Kompani” sh.p.k, me nr. të biznesit ..., duke pretenduar se titulli përbarimor i drejtohet tjetër kujt, ndërsa propozimi për

përmbarrim i drejtohet kompanisë “... - Kompani” sh.p.k, e cila nuk ka legjitimitet me qenë debitor në këtë procedurë përmbarrimore. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar në ligj prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor P.nr.289/18 i dt. 11.06.2018 si dhe të detyrohet kreditori në pagimin e shpenzimeve procedurale.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk përmban kurrfarë arsytimi të bazuar në fakte dhe prova konform nenit 71 dhe 69 par 5 të LPP –së. Pretendimin e debitorit sa i përket asaj se titulli përmbarrimor i drejtohet tjetër kujt e jo debitorit, këtë pretendim kreditori në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar duke ia bashkangjitur certifikatën e regjistrimit nga ARBK –së të debitorit “ ...- Kompani” sh.p.k, me pronar B.S. , andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi si i pa bazuar dhe urdhri për përmbarrim të mbetet në fuqi, njëherit të obligohet debitori në shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, nga fakti se debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim konform nenit 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore (tutje LPP), me te cilën do të mund të kërkonte anulimin e këtij vendimi, sipas kushteve të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarrimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbarruesit Privat P.nr.298/2018 të datës 11.06.2018, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbarrues (titullit ekzekutiv) – vendimit të dhënë në procedurën administrative mbi shqiptimin e gjobës, nr. 4289 të dt. 30.09.2016 i formës së prerë nga dt. 04.11.2016 dhe i ekzekutueshëm nga dt.20.11.2016.

Sipas dokumentit përmbarrues (titullit ekzekutiv) - vendimit të dhënë në procedurën administrative mbi shqiptimin e gjobës, nr. 4289 të dt. 30.09.2016 debitorit i është shqiptuar gjobë në lartësi prej 5.000. 00 euro, me afat prej 15 ditëve pas miratimit të këtij aktvendimi.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbarrimor – vendimi i dhënë në procedurën administrative mbi shqiptimin e gjobës, nr. 4289 të dt. 30.09.2016, është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi (më tej: ujdia);”*, ndërsa me nenin 23. par.2 përcaktohet se: *“ . Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktapajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”* dhe nenin 24 par. 3 të LPP-së përcaktohet se: *““ 3. Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – vendimit në procedurë administrative i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.2, nenit 23 par.2, nenit 24 par. 3 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që vendimi i dhënë në procedurën administrative mbi shqiptimin e gjobës, nr. 4289 të dt. 30.09.2016 i formës së prerë nga dt. 04.11.2016 dhe i ekzekutueshëm nga dt.20.11.2016 është i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Pretendimet e debitorit në prapësim se titulli përmbarimor është lëshuar ndaj dikujt tjetër dhe dallon nga debitori në propozimin për përmbarim, gjykata i refuzoj si të pa bazuara, për arsye se si vendimi në bazë të cilit është iniciuar përmbarimi e po ashtu edhe propozimi për përmbarim përkojnë në mënyrë të saktë lidhur me debitorin e përmbarimit i cili është *“... - Kompani”* sh.p.k me nr. të biznesit ..., me pronar B.S. me nr. personal 1172756120, fakt ky i vërtetuar edhe me certifikatën e biznesit të lëshuar nga ARBK.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 5 par.5 dhe 73 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.10/22, datë 28.09.2022

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.